



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1036/6 prot

Datë 27.04.2026

V E N D I M
Nr. 553/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 27.04.2026, me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “A - M LIFT” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me nr. REF-78358-03 05-2026 me objekt: “Loti 2: Shërbim i mirëmbajtjes së ashensorëve të spitalit Rajonal Vlorë”, me fond limit 1,939,544.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 17-03-2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Class Ashensor” shpk, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

Ankimues:

Operatori ekonomik “A - M LIFT” SHPK, me NIPT (K84616001R) dhe adresë: Lagjja 18, Rruga Aleko Skali, Pallati 10, Hyrja 7.

Autoriteti Kontraktor:

Operatori i Blerjeve te Perqendruara me adresë Rruga “Reshit Çollaku”, Godina Nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë).

Subjekte të Interesuara: “Class Ashensor” shpk me NIPT L01325010Q dhe adresë “Njesia Administrative Nr.5, Rruga Hasan Vogli, Zona Kadastrale 3292, Nr. Pasurie 68/68-d2, Selitë, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 06-03-2026 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-78358-03-05-2026, me objekt “Loti 2:

Shërbim i mirëmbajtjes së ashensorëve të spitalit Rajonal Vlorë”, me fond limit 1,939,544.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 17-03-2026, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.

II.2. Në datën 17-03-2026, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datën 24-03-2026, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. OE “VERTIKUS” SHPK	me vlerë 1,261,500	lekë skualifikuar
2. OE “A - M LIFT” SHPK	me vlerë 1,552,000	lekë skualifikuar
3. OE “CLASS ASHENSOR” SHPK	me vlerë 1,644,900	lekë kualifikuar

II.4. Në datën 31-03-2026, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftim - Fituesi paraprak në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt – ankimi nga ku rezulton skualifikim i OE “A-M Lift” SHPK si më poshtë vijon:

“Arsyet e skualifikimit: Në seksionin 2 te DST AK ka përcaktuar kriterin:

2.14.3 Kriteret/rregullat që duhet të zbatohen për të përcaktuar Lotet që do t'i jepen ofertuesit:

Specifikoni kriteret për të përcaktuar Lotet që do të jepen, kur ofertuesi shpallet fitues i më shumë Loteve sesa numri maksimal i lejuar në pikën 2.14.2.

Shënim: Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare (nënpika 1 e seksionit 2.2, të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike (nënpika 1 e seksionit 2.3 dhe nënpika 3 e seksionit 2.3 (përvec Drejtuesit Teknik inxhinier mekanik, i përfshirë në licencën profesionale të ofertuesit”), të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në rast se dokumentacioni i dorëzuar në përmbushje të kriterëve kumulative nuk plotëson kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të kualifikohet vetëm në lotin/et në të cilin/et oferta e tij është ekonomikisht më e favorshme.

Bazuar në sa më sipër vlerësojmë përmbushjen e kishteve kumulative si më poshtë:

Loti 1: Riparim dhe mirëmbajtje e ashensorëve të Spitalit Korçë

Loti 2: Shërbim i mirëmbajtjes së ashensorëve të spitalit Rajonal Vlorë

a. kapacitetet ekonomike – financiare (nënpika 1 e seksionit 2.2, të kriterëve të veçanta për kualifikim

loti 1- 2.2.1 për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2022-2023-2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të lotit. (1,878,344 lekë pa TVSH)

loti 2- 2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2022-2023-2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të lotit (775,817.6 lekë pa TVSH)

Total të dy lotet 2,654,161.6 lekë pa TVSH

OE AA- M LIFT” sh.p.k. ka xhiro vjetore për vitin 2024 në vlerën 33,553,307 lekë

Kriteri kumulativ përmbushet për të dy lotet

b.kapacitetet teknike (nënpika 1 e seksionit 2.3 (shërbime të ngjashme)

loti 1-2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % e vlerës së fondit limit të lotit (939,172 lekë pa TVSH)

loti 2- 2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % e vlerës së fondit limit të lotit (387,908.80 lekë pa TVSH)

Total të dy lotet 1,327,080.80 lekë pa TVSH

Sherbime te ngjashme me vlerë totale 11,487,500.91 leke pa TVSH

Kriteri kumulativ përmbushet për të dy lotet

c. kapacitetet teknike (nënpika 3 e seksionit 2.3 (përvec Drejtuesit Teknik inxhinier mekanik, i përfshirë në licencën profesionale të ofertuesit)

Loti 1-Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar stafin teknik, për realizimin e shërbimeve objekt prokurimi, sipas profileve të mëposhtme:

b. 1 (një) punonjës elektrikist

c. 1 (një) punonjës mekanik

d. 1 (një) punonjës të çertifikuar për mirëmbajtje ashensorësh

Loti 2 -Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar stafin teknik, për realizimin e shërbimeve objekt prokurimi, sipas profileve të mëposhtme:

b. 1 (një) punonjës elektrikist

c. 1 (një) punonjës mekanik

d. 1 (një) punonjës të çertifikuar për mirëmbajtje ashensorësh

OE AA- M LIFT” sh.p.k. për të dy lotet ka deklaruar në SPE të njëjtin personel në dispozicion të këtyre kontratave :

- E. Z – punonjës elektrikist

- A.K - punonjës mekanik

- A.B – punonjës të çertifikuar për mirëmbajtje ashensorësh

Nga sa me lart OE nuk përmbush kriterin kumulativ “Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet sa shumta e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku” për pikën 2.3.1.

Bazuar në kriteret e sipërshënara (Në rast se dokumentacioni i dorëzuar në përmbushje të kriterëve kumulative nuk plotëson kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të kualifikohet vetëm në lotin/et në të cilin/et oferta e tij është ekonomikisht më e favorshme.) KVO vlerëson ofertën më të favorshme të dhënë nga OE:

Loti 1

Vlera e fondit limit = 4,695,860 lekë pa TVSH

Oferta e OE = 3,521,900 lekë pa TVSH

Ulja në % = 25%

Loti 2

Fondi limit = 1,939,544 lekë pa TVSH

Oferta e OE = 1,552,000 lekë pa TVSH

Ulja në % = 20%

Nga sa më lartë oferta më e favorshme e paraqitur nga OE është ajo e lotit të me vlerë 3,521,900 lekë pa TVSH.

OE "A- M LIFT" sh.p.k. klasifikohet në vendin e parë në lotin 1 dhe skualifikohet në lotin 2 për mospërmbushje të kriterit kumulativ pika 2.3.1"

II.5. Në datën 03.04.2026 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6479 dhe me nr. 1036/2026 prot., datë 07.04.2026 e operatorit ekonomik "A - M LIFT" SHPK, "E hapur, e thjeshtuar" me nr. REF-78358-03 05-2026 me objekt: "Loti 2: Shërbim i mirëmbajtjes së ashensorëve të spitalit Rajonal Vlorë", me fond limit 1,939,544.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 17-03-2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.

II.6. Në përputhje me nenin 112 "Veprimet paraprake" të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr. 1036/1 prot., datë 08.04.2026, lidhur me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik "A - M LIFT" SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.7. Autoriteti kontraktor nëpërmjet postës, ka përcjellë shkresën nr. 1056/10 prot., datë 16.04.2026, protokolluar me tonën me nr.1036/2 prot., datë 20.04.2026, ku verehet se ka dërguar vendimin e KSHA, lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues "A - M LIFT" SHPK. Referuar shkresës së sipërcituar e cila është dërguar edhe nëpërmjet postës elektronike Autoritetit kontraktor, rezulton, se ka vendosur mos pranimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues "A - M LIFT" SHPK.

II.8. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se ne datë 21.04.2026 me shkresën e protokolluar me tonën nr.1036/3, datë 21.04.2026, janë

dorëzuar nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimeve argumente nga operatori ekonomik ankimes “A - M LIFT” SHPK, lidhur me kundërshtimin e vendimit të KSHA-së, për procedurën e prokurimit të sipërcituar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj,

Arsyeton:

III.1. Lidhur ankesën e sipërcituar të OE “A - M LIFT” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tyre në procedurën e mësipërme të prokurimit me arsyen se: *“OE A-m Lift sh.p.k ka dorëzuar te njejtin formular vetedeklarimi per te dyja lotet pasi ka konkurruar per secilin lot vec e vec pa ditur nese oferta e tij do te klasifikohet e suksesshme si dhe per analogji te paragrafit te fundit te nenit 82 te LPP ka paraqitur te njejtin formular. Ne vleresimin e saj per Lotin 2 AK ka shkelur piken 2.14.2 te DST :Në rast se dokumentacioni i dorëzuar në përmbushje të kriterëve kumulative nuk plotëson kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të kualifikohet vetëm në lotin/et në të cilin/et oferta e tij është ekonomikisht më e favorshme Sikunder rezulton nga ato që u sqaruan ne piken 3 ne te dyja rastet oferta e paraqitur nga A-M Lift sh.p.k ka qene me e favorshme dhe AK e ka vleresuar si fitues vetem ne Lotin 1 pasi ky perputhej me kerkesat e specifikimeve teknike te Shtojces 6 per kete lot: Operatori ekonomik kontraktues duhet të paraqitet pranë Spitalit Rajonal Korçë, jo më vonë se 30 minuta nga njoftimi i AK në rast avarie në ashensorët, duke qenë se institucioni ynë është institucion i një rëndësie të veçantë si shërbim spitalor. Në rast se kërkohet të kryhet zëvendësim pjesësh sipas preventivit, Operatori Ekonomik kontraktues, duhet ta kryejë këtë zëvendësim jo më vonë se 24 orë nga njoftimi. Në rast se nuk kërkohet të kryhet zëvendësim pjesësh, shërbimi duhet të kryhet jo më vonë se 2 orë nga njoftimi. Nisur dhe nga vendi i ushtrimit te veprimtarise se OE A-M Lift sh.p.k ky kriter plotesohet per Lotin 1-Korce.”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentat të tenderit, njoftimin e kontaktës pjesa “Seksioni 1: Autoriteti Kontraktor” është parashikuar si më poshtë vijon:

2.14.3 Kriteret/rregullat që duhet të zbatohen për të përcaktuar Lotet që do t'i jepen ofertuesit:

Specifikoni kriteret për të përcaktuar Lotet që do të jepen, kur ofertuesi shpallet fitues i më shumë Loteve sesa numri maksimal i lejuar në pikën 2.14.2.

Shënim: Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare (nënpika 1 e seksionit 2.2, të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike (nënpika 1 e seksionit 2.3 dhe nënpika 3 e seksionit 2.3 (përvec Drejtuesit Teknik inxhinier mekanik, i përfshirë në licencën profesionale të ofertuesit”), të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në rast se dokumentacioni i dorëzuar në përmbushje të kriterëve kumulative nuk plotëson kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të kualifikohet vetëm në lotin/et në të cilin/et oferta e tij është ekonomikisht më e favorshme.

III.1.2. Gjithashtu në shtojcën 9 “FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumentave të tenderit është kërkuar pika 2.3.3 si më poshtë vijon :

“FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

LOTI 1: RIPARIM DHE MIRËMBAJTJE E ASHENSORËVE TË SPITALIT KORÇË

2.3.2 *”Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar stafin teknik, për realizimin e shërbimeve objekt prokurimi, sipas profileve të mëposhtme:*

- a) *1 (një) Drejtues Teknik inxhinier mekanik/elektrik, i përfshirë në licencën profesionale të ofertuesit*
- b) *1 (një) punonjës elektrikist*
- c) *1 (një) punonjës mekanik*
- d) *1 (një) punonjës të certifikuar për mirëmbajtje ashensorësh*

Për punonjësin në pikën a, duhet të paraqitet:

- *Diplomë përkatëse*
- *kontratë pune të vlefshme gjatë periudhës së vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër të lotit*

Për punonjësin në pikën b, c dhe d duhet të paraqitet:

- *kontratë pune të vlefshme gjatë periudhës së vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër të lotit*
- *dëshmi aftësie profesionale (të vlefshme), sipas Ligjit Nr.15/2017, ”Mbi arsimin dhe formimin profesional”, i ndryshuar*

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.”

Si dhe :

“FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

LOTI 2: SHËRBIM I MIRËMBAJTJES SË ASHENSORËVE TË SPITALIT RAJONAL VLORË

2.3.3 ”Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar stafin teknik, për realizimin e shërbimeve objekt prokurimi, sipas profileve të mëposhtme:

- e) 1 (një) Drejtues Teknik inxhinier mekanik/elektrik, i përfshirë në licencën profesionale të ofertuesit
- f) 1 (një) punonjës elektrikist
- g) 1 (një) punonjës mekanik
- h) 1 (një) punonjës të certifikuar për mirëmbajtje ashensorësh

Për punonjësin në pikën a, duhet të paraqitet:

- Diplomë përkatëse
- kontratë pune të vlefshme gjatë periudhës së vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër të lotit

Për punonjësin në pikën b, c dhe d duhet të paraqitet:

- kontratë pune të vlefshme gjatë periudhës së vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër të lotit
- dëshmi aftësie profesionale (të vlefshme), sipas Ligjit Nr.15/2017, ”Mbi arsimin dhe formimin profesional”, i ndryshuar

Ky Kriter konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.”

III.1.3. Komisioni nga verifikimet e kryera konstaton se operatori ekonomik “A-M LIFT” SHPK ka dorëzuar formularin ne secilin prej loteve me të dhënat si më poshtë:

Profili i punonjësve	
<input type="text"/>	-inxhinier mekanik (Drejtues teknik)
<input type="text"/>	punonjës i certifikuar për mirëmbajtje dhe modernizim ashensorësh. Teknik ashensori
<input type="text"/>	-punonjës elektrikist dhe teknik ashensori
<input type="text"/>	-Mekanik ashensori
Shenim: Punonjesit e lartpermendur pjese e stafit jane ata te gatshem per ekzekutimin e kontrates ne rast se OE do te shpallet fitues.	

III.1.4. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

III.1.5. Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.1.6. Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar përcaktohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t’i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm. 2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës...”

III.1.7. Ndërsa në nenin 92/3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe

specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.1.8. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.*

2. *Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon: a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv; b) operatori ekonomik nuk është dënues për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së; c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënues me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së; ç) operatori ekonomik nuk është dënues me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale; d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi; dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së; e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë; ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi; f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës; g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi; gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor; 10 h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti); i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti; j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti; k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.*

3. *Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.*

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur. 7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

III.1.9. Në nenin 42 “Kontrata për punë/mall/shërbim e ndarë në lote”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.

2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.

3. Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit.

4. Autoriteti/enti kontraktor përcakton në njoftimin e kontratës, në ftesën për shprehje interesi ose, kur thirrja për konkurrim bëhet përmes njoftimit për ekzistencën e një sistemi kualifikimi, në ftesën për ofertë ose për të negociuar, nëse ofertat mund të dorëzohen për një, për disa, ose për të gjitha lotet.

5. Autoriteti/enti kontraktor mund të kufizojë numrin e loteve që mund t’i jepen një ofertuesi, me kusht që numri maksimal i loteve për ofertues të deklarohet në njoftimin e kontratës, në ftesën për shprehje interesi, në ftesën për ofertë ose në ftesën për të negociuar.

6. Kur zbatimi i kriterëve për shpalljen e kontratës fituese do të bënte që një ofertues të shpallej fitues i më shumë loteve se sa numri maksimal, autoriteti/enti kontraktor përcakton në dokumentet e tenderit kriteret objektive dhe jodiskriminuese ose rregullat që synojnë të

zbatojnë për të përcaktuar lotet që do të jepen. Këto kritere duhet të jenë në përputhje me LPP-në dhe me ato të përcaktuara në nenin 91 të këtyre rregullave.

7. Kur të njëjtit ofertues mund t'i jepet më shumë se një lot, autoriteti/enti kontraktor mund të japë kontrata që kombinojnë disa ose të gjitha lotet, vetëm nëse ka specifikuar më parë, në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi, mundësinë për ta bërë këtë, dhe lotet ose grupet e loteve që mund të kombinohen.

8. Autoriteti/enti kontraktor mund të përcaktojë kërkesat minimale që u kërkohen operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

9. Në çdo rast, lotet janë të organizuara si procedura të veçanta brenda një procedure. Fillimi dhe përfundimi i njërit lot nuk ndikon në lotin tjetër të procedurës.

III.1.10. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit. Në rastin konkret, nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, rezulton se nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kërkesa se **“Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare (nënpika 1 e seksionit 2.2, të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike (nënpika 1 e seksionit 2.3 dhe nënpika 3 e seksionit 2.3 (përvec Drejtuesit Teknik inxhinier mekanik, i përfshirë në licencën profesionale të ofertuesit)”**, të kriterëve të veçanta për kualifikim), **sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku**. Në rast se dokumentacioni i dorëzuar në përmbushje të kriterëve kumulative nuk plotëson kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të kualifikohet vetëm në lotin/et në të cilin/et oferta e tij është ekonomikisht më e favorshme.” dhe lidhur kjo me arsyen e skalifikimit të operatorit ekonomik ankimues “A-M LIFT” SHPK se “OE A- M LIFT” sh.p.k. për të dy lotet ka deklaruar në SPE të njëjtin personel në dispozicion të këtyre kontratave” plotësimi ose jo i kësaj kërkesë mund të përbëjë shkak për skualifikimin e një operatori ekonomik. Për pasojë, gjykojmë se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentat e tenderit e, rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Në rastin në shqyrtim, operatori ekonomik ankimues “A-M LIFT” SHPK ka paraqitur për procedurën “Loti 1: Riparim dhe mirëmbajtje e ashensorëve të Spitalit Korçë” dhe për procedurën “Loti 2: Shërbim i mirëmbajtjes së ashensorëve të spitalit Rajonal Vlorë” të njëjtin formular publikimi ku në përmbushje të kriterit 2.3.3 të secilit lot të sipërpërmendur, konstatohet, deklarimi i punonjësve:

- 1- E.S (inxhinier mekanik , Drejtues Teknik)
- 2- A.B (punonjës i certifikuar për mirëmbajtje dhe modernizim ashensorësh, Teknik Ashensori)
- 3- E.Z (punonjes elektrikist dhe teknik ashensori)
- 4- A.K (Mekanik Ashensori)

Në këtë kuadër, Komisioni gjykon, se deklarimi i punonjësve me të dhënat respektive të kërkuar në seksionin përkatës të secilit formular përmbledhës të vetëdeklarimit në secilin prej loteve, në stadin në të cilin ndodhet procedura e vlerësimit, sjell mos përmbushjen të kriterit të vendosur në NJOFTIMIN E KONTRATËS, Seksioni 1 pika 2.14.3 kur ofertuesi shpallet fitues i më shumë Loteve sesa numri maksimal i lejuar duhet të deklaronte kriteret e kërkuara sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar. Në përfundim të argumentimit të mësipërm, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga OE ankimues “A-M LIFT” sh.p.k në procedurën e prokurimit, nuk e plotëson kërkesën e autoritetit kontraktor dhe si i tillë konsiderohet i pavlefshëm për lotin 2 pasi *nënpika 1 e seksionit 2.3 dhe nënpika 3 e seksionit 2.3 (përvec Drejtuesit Teknik inxhinier mekanik, i përfshirë në licencën profesionale të ofertuesit*”), stafi tjetër duhet të ishtë sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku pra përvec drejtuesit teknik 2 profilet e tjera duhet të ishin sa shuma e loteve në total 4 të tillë nga 2 që ka paraqitur operatori ekonomik ankimes “A-M LIFT” sh.p.k duke sjellë mosplotesimin e kriterit.

Për sa më sipër, pretendimi i OE ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin tjetër të operatorit ekonomik ankimes “A-M LIFT” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës të paraqitura nga operatori ekonomik “Class Ashensor” SHPK nga procedura e prokurimit objekt - shqyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për sa kohë që pretendimet e operatorit ekonomik ankimes ofertën e paraqitur prej tyre, nuk qëndrojnë, pasi operatori ekonomik “A-M LIFT” SHPK, nuk përmbush kriteret e kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike edhe pas arsyetimit të KPP, do të mbetet e skualifikuar, trajtimi i pretendimeve të ankimesit në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik “Class Ashensor” SHPK nuk kanë ndikim mbi fatin e çështjes, pasi bazuar në legjislacionin në fuqi për prokurimin publik, interesi i ligjshëm i drejtpërdrejtë i ankimesit, nuk ka sesi të dëmtohet nga sukcesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në këtë procedurë prokurimi, pasi edhe në hipotezën që këto pretendime do të pranoheshin, ai sërish nuk do të mund të shpallej fitues i kontratës objekt – prokurimi.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e OE “A-M LIFT” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me nr. REF-78358-03 05-2026 me objekt: “Loti 2: Shërbim i mirëmbajtjes së ashensorëve të spitalit Rajonal Vlorë”, me fond limit 1,939,544.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 17-03-2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.
 2. Autoriteti kontraktor të vijoj me hapat e mëtejshme të procedrës së prokurimit.
 3. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kalimin e tarifës financiare në buxhet të shtetit, të paguar nga OE “A-M LIFT” SHPK.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro

